



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr,71 datë 12.06.2020

PËR

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 28, DATË 24.03.2020, TË KËSHILLIT BASHKIAK “PËR KRIJIMIN E LEHTËSIRAVE FISKALE NDAJ BIZNESIT DHE SHTYRJEN E AFATEVE TË APLIKIMIT PËR PROGRAMET SOCIALE TË STREHIMIT NË KUADËR TË MASAVE PËR PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË INFEKSIONIT COVID-19”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 23, pika 6, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 113, të Ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, vendimit nr. 243, datë 24.3.2020, të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 158 datë 26.12.2019 “Për miratimin e sistemit të taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës”, Urdhrin 156, datë 10.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta në parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19”, Aktit Normativ nr.3 datë 15.03.2020 të Këshillit të Ministrave “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid -19” dhe Aktit Normativ Nr.4 date 16.03.2020 “Për disa shtesa të Aktit Normativ Nr.3 datë 15.03.2020 të Këshillit të Ministrave “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid -19”, vendimin nr. 28 datë 24.03.2020 “Për krijimin e lehtësirave fiskale ndaj biznesit dhe shtyrjen e afateve të aplikimit për programet sociale të strehimit në kuadër të masave për parandalimin e përhapjes së infeksionit Covid-19” i ndryshuar, me propozim të kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

Në vendimin nr. 28, datë 24.03.2020, të Këshillit Bashkiak “Për krijimin e lehtësirave fiskale ndaj biznesit dhe shtyrjen e afateve të aplikimit për programet sociale të strehimit në kuadër të masave për parandalimin e përhapjes së infeksionit Covid-19”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2, shkronja “b” togfjalëshi “ për në fund të muajit qershor 2020”, zëvendësohet me togfjalëshin “për në datën 15 korrik 2020” ndryshohet si më poshtë:

1.1. Pas pikës 2/1 shtohet pika 2/2 me përmbajtje si më poshtë:

“2/2. Përfshirjen nga pagesa e tarifës së pastrimit proporcionalisht për një periudhë 10 mujore, për periudhën 01 mars 2020 deri më 31 dhjetor 2020, për kategoritë e subjekteve që ushtrojnë aktivitetin e tyre në transportin publik të udhëtarëve qytetas dhe rrethqytetas”.

2. Çdo parashikim tjetër që ka të bëjë me masat lehtësuese të tarifës së pastrimit për kategoritë e subjekteve që ushtrojnë aktivitetin e tyre në transportin publik të udhëtarëve

qytetas dhe rrethqytetas dhe që bie ndesh me këtë vendim, shfuqizohet.

3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas parashikimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar.

K R Y E T A R

TONI GOGU

RELACION

PËR

**NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 28, DATË 24.03.2020, TË KËSHILLIT
BASHKIAK “PËR KRIJIMIN E LEHTËSIRAVE FISKALE NDAJ BIZNESIT DHE
SHTYRJEN E AFATEVE TË APLIKIMIT PËR PROGRAMET SOCIALE TË**

STREHIMIT NË KUADËR TË MASAVE PËR PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË INFEKSIONIT COVID-19”, TË NDRYSHUAR

Si pasojë e situatës së krijuar nga Covid-19 dhe në vazhdimësi të ndryshimeve në Paketën Fiskale miratuar me: Vendimin Nr.28 datë 24.03.2020 “Për krijimin e lehtësirave fiskale ndaj biznesit dhe shtyrjen e afateve të aplikimit për programet sociale të strehimit në kuadër të masave për parandalimin e përhapjes së infeksionit COVID-19”, në pikën 2 citohet se është vendosur lehtësimi i barrës fiskale për biznesin duke përjashtuar nga pagesa e tarifës së zënies së hapësirës publike për muajin Mars, Prill 2020; shtyrjen e afatit të pagesës së taksave dhe tarifave vendore nga muaji Prill për në fund të muajit Qershor 2020 dhe shtyrjen e afatit të këstit të pagesës së taksave dhe tarifave vendore të muajit Qershor për në fund të muajit Gusht 2020;

Gjithashtu me Vendimin nr.60 datë 01.06.2020 “Për disa shtesa në Vendimin Nr.28 datë 24.03.2020 “Për krijimin e lehtësirave fiskale ndaj biznesit dhe shtyrjen e afateve të aplikimit për programet sociale të strehimit në kuadër të masave për parandalimin e përhapjes së infeksionit COVID-19” është vendosur përjashtimi nga pagesa e tarifës së zënies së hapësirës publike për baret dhe restorantet për periudhën maj - qershor 2020”, dhe ulja e detyrimit të lindur nga tarifa e pastrimit proporcionalisht për një periudhë 2 mujore për kategoritë:

Njësi shërbimi

- Bar kafe;
- Restorant, fast food etj te ngjashme me to;
- Pub, diskoteka etj te njashme;
- Kafe internet, lojëra fati, qendra interneti;
- Hotele, motele ;
- Komplekse sportive, palestra, fitnes, pishina, qendra e institute kërkimore - shkencore, salla koncerte-mbledhje e videoteka;
- Lojëra me kompjuter, lojëra fëmijësh të hapura dhe të mbyllura;

Transport pasagjerësh

- Automjet deri 5 vende
- Automjet 6-9 vende
- Automjet 10-25 vende
- Automjet 26-42 vende
- Automjet mbi 42 vende”.

Në kategorinë “Transport pasagjerësh” të përjashtuar nga tarifa e pastrimit proporcionalisht për një periudhë 2 mujore janë të pasqyruar automjete, të cilat përdoren për transportin publik të udhëtarëve qytetas. Të detyruar të qëndrojnë pa aktivitet nga situata e krijuar, shoqëritë të cilat merren me transportin publik në Qytetin e Tiranës gjenden në një situatë të vështirë financiare.

Në vijim të korrespondencave të mbajtura me shoqatën Kombëtare të Transportit Qytetas në Bashkinë e Tiranë ku kërkohet rishikimi i detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore nga ana jonë, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, e cila është përgjegjëse për mirëadministrimin e çdo çështje që lidhet me burimet financiare të Bashkisë Tiranë, duke ndjekur proceset që prej parashikimit të të ardhurave afatmesëm dhe vjetor, nga të gjithë aktorët brenda apo jashtë strukturave të institucionit, si dhe kryen monitorimin dhe koordinimin e proceseve të realizimit të tyre deri në rakordimin final të tyre, duke identifikuar, ideuar dhe ofruar krijimin e një potenciali zhvillues, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, vlerëson, se në situatën aktuale në të cilën gjenden shoqëritë e transportit duhet të përjashtohen nga pagesa e tarifës së pastrimit, pasi duke mbajtur në konsideratë mbi- realizimit të disa zërave të të ardhurave aktuale si: Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin dhe Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, të cilët për periudhën 4

mujore kanë një tejkalim mbi parashikimin e planifikuar. Përkatësisht automjetet të cilat kryejne transportin publik te udhëtareve qytetas dhe rrethqytetas për periudhen 01 mars – 31 dhjetor 2020 (duke e shfuqizuar vendimin e parë për periudhën 2 mujore për këtë kategori).

Impakti financiar i përjashtimit të kësaj kategorie nga pagesa e tarifës së pastrimit, proporcionalisht për një periudhe 10 mujore do të llogaritet dhe do të pasqyrohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, në një vendim pasardhës të Këshillit Bashkiak.

Duke shprehur për miratimin e këtij materiali nga ana juaj,

Ornela Kurti,

Specialist, Sektori i Asistencës Ligjore dhe Legjislacionit

Sokol Dedja,

Specialist, Drejtoria e Monitorimit të Taksës dhe Tarifave Vendore

Jonida Rudaj

Përgjegjës, Sektori i Asistencës Ligjore dhe Legjislacionit

Edlira Koço

Drejtor, Drejtoria e Monitorimit të Taksës dhe Tarifave Vendore

Laura Deliu

Drejtor, Drejtoria Juridike

Jonida Halili

Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar

Taulant Tusha,

Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike

Alban Dokushi

Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit

Arli Naska

Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore

Arbjan Mazniku

Zv. Kryetar

Znj. Esmeralda Demiraj
Përgjegjës i Këshillit Bashkiak

Z. Behar Zeneli
Sekretari i Këshillit Bashkiak



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
KRYETARI

Nr. _____ prot.

Tiranë, më __, __, 2020

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

ZOTIT TONI GOGU
KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

TIRANË

I nderuar zoti Kryetar,

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për shqyrtim dhe miratim relacionin dhe projektvendimin “Për një shtesë në vendimin nr. 28, datë 24.03.2020, të Këshillit Bashkiak “Për krijimin e lehtësirave fiskale ndaj biznesit dhe shtyrjen e afateve të aplikimit për programet sociale të strehimit në kuadër të masave për parandalimin e përhapjes së infeksionit covid-19”, të ndryshuar”.

K R Y E T A R I

Erion VELIAJ

Konceptoi dhe punoi:

Specialist i SZB: S. Dedja

Specialist i SALL: O.Kurti

Miratoi:

Përgjegjës i SALL: J. Rudaj

Drejtor i DJ: E. Koco

Konfirmoi:

Drejtor i DPMF: J. Halili

Drejtor i DPJAL: A. Dokushi

Drejtor i DPPP: T.Tusha

Nr.i kopjeve: 4 datë 11.06.2020